



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi

*ndërmjet*



Organit Kombëtar të Investigimeve të Aksidenteve  
dhe Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil

*dhe*



Kompanisë Ajrore BelleAir



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## PËRMBAJTJA

1. Fjalori
2. Hyrje
3. Terminologja
4. Qëllimi
5. Mirëkuptim i ndërsjelltë dhe bashkëpunimi në rast Aksidenti/Incidenti.
6. Bashkëpunimi në fushën Teorike për ngritjen e nivelit të Sigurisë.
7. Rolet dhe Detyrat e Palëve.
8. Principet bazë të MB
9. Kontaktet

### Fjalori (shpjeguesi i termave të përdorura)

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AC	Aviacioni Civil
TIA	Tirana International Airport
MB	Memorandum Bashkëpunimi
RSh	Republika e Shqipërisë
CVR	Cockpit Voice Recorder
FDR	Flight Data Recording
OKIIA	Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve
A/C	Aircraft (avion)
FOD	Flight Operation Department
F/Disp.	Flight Dispatch
F/Ops.Mg.	Flight Ops Manager
GOD	Ground Operation Department
G/Ops.Mgr.	Ground Ops.Manager
VQA	Vend Qendrim i A/C (Apron)
Txw	Rruja e A/C për dhe nga Pista
Rnw	Pista e ngritjeve dhe uljeve të A/C.
F/Doc.	Dokum.e fluturimit (ATS Flp, Company Flp., Load & Trim sheet, Wather Info.Notams , Pax.&Cargo Manifest)
A/C.Doc	Të Gjitha dokumentat e Avionit përfshi certifikatat: AOC, Regjistrimit, Airworthinees, Zhurmës, Manualet dhe Jepssen
IND	Investigatori në Detyrë i OKIIA



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË



100 Vjet Pavarësi

## 1. Hyrje

- 1.1 Ky Mermorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi shpreh mirëkuptimin e OKIIA dhe të BelleAir, të cilave më pas do ti referohemi si Palët në këtë MB, lidhur me bashkëpunimin dhe asistencën në rastin e një Aksidenti/Incidenti në fushën e AC. Dihet se të dy Palët i përgjigjen ligjeve të RSh-së dhe për këtë arsyet ata janë të lidhur nga standartet e përfshira në këtë legjislacion:
  - a) Ligji Nr.10040, datë 22.12.2008, Për “Kodin Ajror” te RSh i ndryshuar.
  - b) Ligji Nr. 10233, datë 11.02.2010, Për “Aviacionin Civil” i ndryshuar.
  - c) Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.68, datë 2.6.2010, Për krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil.
- 1.2 Ky MB përcakton masat proceduriale për bashkëpunim dhe asistencë midis Palëve në përputhje me legjislacionin e mësipërm.

## 2. Terminologja

- 2.1 Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë dokument, kanë të njëjtin kuptim ashtu si përshkruhet në legjislacionin e RSh.

## 3. Qëllimi

- 3.1 Memorandumi i Bashkëpunimit (më poshtë do të shkruhet MB) ka si qëllim që, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, kordinimin e veprimeve në hapsirën e ndodhjes së ngjarjes , dhënien nga BelleAir të dokumentave të ndryshme të A/C dhe të fluturimit të A/C të aksidentuar ose të përfshirë në incident, mbështetjen e palëve me specialistë ose expertë, për të kryer një investigim sa më objektiv në nxjerrjen e shkaqeve të aksidentit/incidentit të ndodhur.
- 3.2 Nëpërmjet këtij MB, Palët synojnë të ndihmojnë në kryerjen e një investigimi të saktë e të shpejtë për nxjerrjen e shkaqeve të aksidentit/incidentit, me qëllimin parësor të parandalimit të tyre në të ardhmen.

## 4. Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi i ndërsjelltë

- 4.1 MB angazhon BelleAir në informimin sa më të shpejtë nëpërmjet FOD në rastin e ndodhjes së një aksidenti/incidenti në rajonin e Aerodromit dhe jashtë tij, gjithashtu edhe ato të ndodhura në destinacionet përkatëse jashtë territorit të RSh.
- 4.2 Palët punojnë së bashku në përgatitjen dhe zbatimin e rekomandimeve të cilat u jepen operatorëve për parandalimin e aksidenteve/ incidenteve në të ardhmen.
- 4.3 MB synon rritjen e efikasitetit në kryerjen e detyrës e të dy Palëve, në rast të një incidenti/aksidenti të rëndë:
  - a) Përmirësimin e sigurisë së fluturimit dhe të lëvizjëve së A/C në tokë.



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË



100 Vjet Pavarësi

- b) Përpikmërinë e kryerjes së së mirëmbajtjes A/C ne bazë të standarteve të parashikuara në rregulloret dhe manualet përkatëse.
  - c) Përmirësimin e masave në raste Emergjencash si: ulje e detyruar brenda dhe jashtë Aerodromit, në rast të zjarrit, në rast të evakuimit të pasagjerëve.
  - d) Në perfeksionomin e vazhdueshëm profesional të Ekuipazheve Fluturuese dhe atyre të kabinës.
- 4.4 Nëpërmjet këtij MB, BelleAir gjitha`ashtu me kërkesën e OKIIA ndihmon me specialist pilotë e teknikë në kryerjen e Investigimeve (për çdo rast palët do të bihen dakort paraprakisht).
- 4.5 BelleAir me kërkesë të IND të OKIIA, ndihmon me mjete dhe paisje për çmontim pjesësh dhe magazinim të tyre të përkohshëm (për çdo rast palët do të bihen dakort paraprakisht).
- 4.6 BelleAir në rast të një aksident/incident siguron për IND dokumentet si me poshtë:
- Listë e plotë të pasagjerëve në ngritje ose ardhje nëpërmjet FOD.
  - Fletën e Load dhe Trim sheet të A/C që pëson ngjarjen.
  - Fletën e shërbimeve të kryera nga G/Ops ose G/Service të Aeroportit.
- 4.7 BelleAir siguron për IND të gjithë dokumentat personale të ekuipazhit në rast të tillë.
- 4.8 IND kryen investigimin në mënyrë të pavarur në fushën teknike dhe pjesëmarra e tij në investigim nuk ka për qëllim përcaktimin e përgjegjësisë apo të fajit.
- 4.9 Ky MB nuk kufizon diskrecionin dhe kompetencat e secilës palë bazuar në legjislacion.

## 5. Bashkëpunimi në fushën teorike për rritjen e nivelit të Sigurisë.

- 5.1 Secila palë pranon rolin e rëndësishëm të palës tjeter në lidhje me interesin publik dhe nevojën e kryerjes së detyrës sa më mirë dhe brenda një kohe sa më te shkurter, bazuar ne detyrimet e tyre ligjore.
- 5.2 Palët sigurojnë pjesëmarje në seminare dhe analiza të organizuara prej tyre për problemet e Sigurisë së Fluturimeve në Aeroport.
- 5.3 Palët marrin përsipër të organizojnë takime e konsultime për probleme të veçanta në rang specialistësh dhe ekspertësh.



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË



100 Vjet Pavarësi

## 6. Rolet dhe Detyrat e përbashkëta.

- 6.1 BelleAir duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur OKIIA për çdo rast incidenti/aksidenti të një A/C në zonën e aerodromit.
- 6.2 BelleAir i jep IND të OKIIA të dhëna për identifikimin e zonës së ndodhjes së ngjarjes: tipi i avionit, numri i fluturimit, shenja e thirrjes, origjina dhe destinacioni i fluturimit.
- 6.3 BelleAir nuk duhet të japë informacion për Media pa u konsultuar më parë me IND.

## 7. Parimet bazë të MB

- 7.1 Palët sigurojnë që do të ndërmarrin hapa të ndjeshëm që Inspektorët e OKIIA dhe Personeli Flight dhe Ground Operations i BelleAir të familiarizohen me përbajtjen e kërkesat e MB.
- 7.2 Palët mund t'a ndryshojnë këtë MB në çdo moment duke rënë dakort midis tyre. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim dhe do të jetë një shtojcë e këtij MB, i cili hyn në fuqi në datën që bihet dakort në shtojcë.
- 7.3 Ky MB hyn në fuqi menjëherë në datën që nënshkruhet nga të dy palët, dhe ka vlefshmëri 2 (dy) vjet. Në mbarim të këtij afati, mund të rishikohet dhe/ose të riaprovohet një afat i ri vlefshmërie.
- 7.4 Secila palë në çdo moment mund të shprehë me njoftim me shkrim, të paktën 3 (tre) muaj par apërfundimit të afatit) qëllimin e saj për rishikimin/ndërprerjen e këtij MB.

## 8. Kontaktet për zbatimin e MB.



P.O.Box74  
Tiranë, Shqipëri  
tel:  
fax:  
mobile: +355 696060022  
e-mail: [info@okia.gov.al](mailto:info@okia.gov.al)



Pallati Kulturës, Kati dytë  
Tiranë, Shqipëri  
tel:  
fax:  
mobile:  
e-mail:

Dipl.Ing. Arben Xhiku  
Drejtor i Përgjithshëm



Z. Arbi XHELO  
Drejtor i Përgjithshëm

